

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë  
Misioni në Kosovë

**SHQYRTIM I RASTEVE TË**  
*riuzurpimit të paligjshëm*  
**NË KOSOVË**



## PËRMBAJTJA

|  |    |
|--|----|
| 1. HYRJE.....  | 3  |
| 2. KORNIZA LIGJORE NDËRKOMBËTARE DHE E Kosovës .....   | 5  |
| 3. SHQETËSIMET e identifikuara në trajtimin efektiv të rasteve të riuzurpimit të paligjshëm..... | 6  |
| 3.1 Historiku .....  | 6  |
| 3.2 Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) .....                                  | 7  |
| 3.2.1 Dorëzimi i kallëzimeve penale në Policinë e Kosovës.....                                   | 7  |
| 3.2.2 Përcjellja e rastit.....   | 8  |
| 3.3 Çështjet lidhur me zyrat e prokurorisë.....  | 9  |
| 3.3.1 Rastet ende të pazgjidhura pranë zyrave të prokurorisë .....                               | 9  |
| 3.3.2 Koha e nevojshme për të ngritur aktakuzën .....  | 10 |
| 3.3.3 Përmbajtja e aktakuzës.....  | 11 |
| 3.3.4 Akuzat e ngritura.....   | 11 |
| 3.3.5 Ndëshkimet e kërkuara.....   | 12 |
| 3.4 Çështjet që kanë të bëjnë me gjykatat .....  | 12 |
| 3.4.1 Vonesat e paarsyeshme.....   | 12 |
| 3.4.2 Shqiptimi i dënimit .....  | 13 |
| 3.4.3 Kompensimi .....   | 15 |
| 3.4.4 Ekzekutimi i dënimeve .....  | 15 |
| 4. PËRFUNDIM .....   | 16 |
| 5. REKOMANDIME.....  | 18 |

## **LISTA E SHKURTESAVE**

**KPK** Kodi i Procedurës Penale

**KEDNJ** Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut

**GJEDNJ** Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

**PK** Policia e Kosovës

**AKP** Agjencia e Kosovare e Pronës

**OSBE** Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

**DUDNJ** Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

## **LISTA E DIAGRAMEVE**

**Grafiku 1:** koha mesatare në muaj për trajtimin e rasteve të riuzurpimit të paligjshëm sipas rajonit të Gjykatës Themelore (deri në tetor 2014)

**Grafiku 2:** numri i aktgjyqimeve për rastet e riuzurpimit të paligjshëm sipas muajit (deri në tetor 2014)

**Grafiku 3:** shpërndarja rajonale e rasteve të referura nga AKP-ja në zyrat e prokurorisë (deri në tetor 2014)

**Grafiku 4:** trajtimi i rasteve të pranuar nga zyrat e prokurorisë (deri në tetor 2014)

**Grafiku 5:** numri i muajve që nevojiten për të ngritur aktakuzën (deri në tetor 2014)

**Grafiku 6:** Statusi i lëndëve në gjykatat themelore (deri në tetor 2014)

**Grafiku 7:** Muajt që u janë dashur gjykatave themelore për t'i zgjidhur lëndët, kundrejt numrit të lëndëve të pazgjidhura për gjyqtar në secilën gjykatë themelore (deri në tetor 2014)

**Grafiku 8:** Dënimet e shqiptuara pas nxjerrjes së aktgjykimit dënues (deri në tetor 2014)

**Grafiku 9:** Gjjobat e paguara sipas gjykatave themelore (deri në tetor të vitit 2014)

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport shqyrton reagimet e institucioneve të Kosovës në rastet e riuzurpimeve të paligjshme të pronave nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) dhe paraqet një vlerësim të trajtimit të përgjithshëm të rasteve të riuzurpimit të paligjshëm nga sistemi në fuqi<sup>1</sup>. Riuzurpimi i paligjshëm ndodh kur një individ ose një grup individësh, të cilët janë dëbuar nga një pronë në bazë të një urdhri të ligjshëm për dëbim, më pas e uzurpojnë sërish atë. Riuzurpimi i pronës për të cilën është lëshuar një urdhër dëbimi përbën vepër penale sipas Kodit Penal të Kosovës dhe në ato raste mund të shqiptohet dënimi deri në tre vjet burgim. Riuzurpimi i paligjshëm i pronave është fenomen i pranishëm në tërë Kosovën që ndikon edhe në pronat private edhe në ato nën administrimin e AKP-së. Rastet e riuzurpimit të pronave nën administrimin e AKP-së për të cilat AKP ka ngritur kallëzim penal në prokurori janë kryesisht të natyrës ndëretnike, që përfshijnë një pronar serb të pronës dhe një uzurpues shqiptar. Gjykimi efektiv i këtyre rasteve do të kontribuojë jo vetëm në krijimin e sigurisë ligjore por edhe do të ndihmojë në përpjekjet e pajtimit ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës.

Për të vlerësuar reagimin e institucioneve në rastet e riuzurpimeve të paligjshme, OSBE ka shqyrtuar të gjitha rastet që përfshijnë prona nën administrimin e AKP-së në periudhën 2008 deri 2013. Kufizimi i mbulimit të hulumtimit vetëm në pronat e administruara nga AKP ka mundësuar identifikim të lehtë të pronave që janë subjekt i riuzurpimit. Një pengesë e këtij vendimi ishte se janë lënë jashtë riuzurpimet e paligjshme të pronave në zotërim vetanak dhe nën administrim të pronarëve privatë, të cilat janë raste po aq të rëndësishme. Meqë të gjitha rastet kanë të bëjnë me riuzurpimin, dëbimi fillestar nga AKP me ndihmën e Policisë së Kosovës (PK) është kryer në të gjitha këto raste. OSBE-ja ka shqyrtuar progresin e çdo rasti nga identifikimi fillestar i riuzurpimit të paligjshëm deri te përmbarimi i vendimit të plotfuqishëm. Vlerësimi ka gjetur shqetësime serioze në lidhje me zbatimin e dëbimeve nga ana e institucioneve të Kosovës. Këto raste nuk janë komplekse nga ana juridike: rastet përgjithësisht përfshijnë një të pandehur; sasia e provave është mesatare; shkalla e kompleksitetit të çështjeve juridike të përfshira është e ulët; dhe nuk ka konteste të pazgjidhura pronësore.

Megjithatë, përkundër thjeshtësisë relative të tyre, për shkak të reagimit të ngadaltë të prokurorisë dhe gjyqësorit, këto raste mesatarisht zgjasin dy vite e tre muaj për t'i proceduar nga koha kur lënda dorëzohet nga AKP në zyrën e prokurorisë deri tek aktgjykimi i plotfuqishëm i një gjykate themelore. Përveç kësaj, mund të vërehen një numër mangësish tjera në reagimin e autoriteteve në rastet e riuzurpimit të paligjshëm të cilat parandalojnë zgjidhjen efektive të këtyre rasteve. Këto përfshijnë faktin që: AKP nuk informon PK-në për riuzurpimin e paligjshëm, duke i lënë uzurpuesit e paligjshëm në pronë gjatë tërë procedurës së lëndës; prokuroria nuk ka nënvizuar natyrën ndëretnike të rasteve dhe nuk ka kërkuar ndëshkime të rrepta; dhe gjykatat nuk kanë urdhëruar ridëbim; gjykatat gjithashtu kanë prirje të nxjerrin dënime të shkurtra, të dënimit me kusht, gjë që nuk është masë për parandalimin e

---

<sup>1</sup> Procedurat për trajtimin e rasteve riuzurpimit të paligjshëm dhe faktet themelore të riuzurpimit të paligjshëm janë të njëjta pavarësisht nëse AKP administron pronën ose prona është në administrim privat. Kështu, shqyrtimi i rasteve që përfshijnë rastet e administruara nga AKP mund të zbardhë mënyrën se si me gjasë trajtohen nga sistemi edhe rastet që përfshijnë prona që nuk administrohen nga AKP.

këtyre rasteve; dhe gjykatat nuk kanë nxjerrë urdhra për rikthim të pronës për kompensimin e pronarëve të pronës.

Koordinimi më i mirë nga ana e institucioneve përkatëse ekzekutive dhe një fokus më i madh në seriozitetin e këtyre rasteve nga ana e gjykatave me siguri do të çonte në zbatim dukshëm më të mirë të rasteve të riuzurpimit të paligjshëm dhe ulje të këtyre rasteve në të ardhmen. Raporti përfundon me rekomandime të cilat, mes tjerash, nënvizojnë nevojën që veprat të kualifikohen në mënyrë adekuate nga prokuroria, dhe që gjykatat ta kryejnë procesin gjyqësor në kohë, të nxjerrin vendime bazuar në rrethanat individuale të rasteve, dhe që gjithmonë në dispozitiv të urdhërohet lirimin e pronës së uzurpuar nga ana e uzurpuesve të paligjshëm, në vend që të shqiptohen dënime me kusht, si rregull i përgjithshëm.

## 1. HYRJE

Zbatimi i urdhrave për dëbim dhe administrim të pronës në tërë Kosovën vazhdon të jetë sfidues. Raporti i Progresit për Kosovën 2013, i publikuar nga Komisioni Evropian, konstatoi se janë rreth 820 dëbime të pakryera, nga të cilat rreth 350 janë në veriun e Kosovës<sup>2</sup>. Shumë kërkesa të pazgjdhura për kompensim të pronës qëndrojnë në gjykata dhe shpeshherë urdhrat për dëbim në rastet e zgjidhura nuk respektohen, ku personat e dëbuar kthehen dhe riuzurpojnë pronat. Ndërmjet viteve 2008 dhe 2013, Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) ka referuar 326 raste të tilla të riuzurpimit në prokurori, të cilat kishin të bënin me prona nën administrimin e saj<sup>3</sup>, dhe numri i riuzurpimeve të paligjshme në të gjithë Kosovën me gjasë është më i lartë kur përfshihen edhe pronat që nuk janë nën administrimin e AKP-së.<sup>4</sup>

Zgjidhja efektive e rasteve të riuzurpimit të paligjshëm është me rëndësi të madhe për të drejtat dhe integritetin e komunitetit serb të Kosovës. Mbi 95 për qind të rasteve të AKP-së që janë referuar në zyrat e prokurorisë përfshinin prona të pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës që janë riuzurpuar paligjshëm nga pjesëtarë të komunitetit shqiptar në Kosovë. Ekziston një histori e dhunës së lidhur me pronat në Kosovë, e cila vazhdon edhe në ditët e sotme. Për shembull, kanë qenë rreth 120 vepra pronësore të raportuara në Policinë e Kosovës (PK) gjatë tërë Kosovës në vitin 2013. Prandaj, zgjidhja efektive e këtyre rasteve të riuzurpimit të paligjshëm është po ashtu me rëndësi kritike për sigurinë dhe sundimin e ligjit në Kosovë.

Rastet e riuzurpimit të paligjshëm të pronave nuk janë komplekse nga aspekti juridik, meqë ato përgjithësisht përfshijnë një të pandehur, sasia e dëshmive është jo mbi mesataren, shkalla e kompleksitetit të çështjeve juridike të përfshira është e ulët, si dhe nuk ka konteste të pazgjdhura pronësore. Duke i pasur parasysh këto arsye, zyrat e prokurorisë duhet t'i ngrisin aktakuzat edhe më herët se që kanë vepruar gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport.

---

<sup>2</sup> Shih Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2013, të Komisionit Evropian në: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2013/package/brochures/kosovo\\_2013.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/kosovo_2013.pdf)

<sup>3</sup> Nga 326 raste, 65 raste janë nga rajoni i Mitrovicës/Mitrovica. Rastet që AKP i ka trajtuar deri më tani kanë të bëjnë vetëm me pronat në jug të lumit Ibër.

<sup>4</sup> Rastet e riuzurpimit të paligjshëm që përfshijnë prona që nuk janë të administruara nga AKP nuk mund të identifikohet lehtësisht. AKP-ja nuk mban të dhëna mbi rastet e riuzurpimit të paligjshëm që kanë të bëjnë me pronat që ajo nuk i administron.

Qëllimi i raportit është të përcaktojë nëse institucionet e Kosovës janë duke ofruar zgjidhje efektive për rastet e riuzurpimeve të paligjshme. Në përputhje me mandatin e OSBE-së për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave pronësore të komuniteteve të Kosovës, si dhe sigurinë dhe sundimin e ligjit në Kosovë, ky raport ofron një analizë të reagimit të institucioneve të Kosovës në këto raste duke shfrytëzuar një nëngrup të pronave të riuzurpuara paligjshëm të administruara nga AKP.

Kur AKP dëbon shfrytëzuesin fillestar të paligjshëm të pronës, pronari i pronës ka të drejtë të zgjedhë në mes administrimit të pronës së tij nga AKP ose riposedimit. Nëse zgjidhet kjo e fundit, AKP më nuk e monitoron pronën, për shembull për të siguruar se ajo nuk është riuzurpohet, dhe nuk ndërmer veprime në rast se ajo riuzurpohet. Në këtë rast, pronari duhet ta ngrisë çështjen e riuzurpimit tek institucionet përkatëse vendore.

Gjetjet e raportit janë bazuar në një analizë sasiore dhe cilësore të të dhënave të marra nga AKP, si dhe të aktakuzave, propozim-akuzave dhe aktgjykimeve të mbledhura nga shtatë zyra rajonale të prokurorive themelore dhe shtatë gjykatave themelore në Kosovë.

Për realizimin e këtij vlerësimi, monitoruesit e sistemit të drejtësisë të OSBE-së kanë përcjellë trajtimet e institucioneve të të gjitha rasteve të AKP-së. Në kohën e raportimit, në gjykim janë futur 137 raste. Nga këto raste, gjykatat kanë qenë në gjendje të prodhojnë shkresa të lëndës, përfshirë aktakuza, aktgjykime dhe dënime për 117 raste<sup>5</sup>. Këto 117 raste janë nëngrupi i rasteve që përbëjnë bazën e këtij raporti. OSBE-ja ka kryer një shqyrtim të thellë të aktakuzave dhe aktgjykimeve të shqiptuara në këto raste për ta vlerësuar dhe krahasuar kualifikimin e veprave penale me dënimet e shqiptuara. Krahas shqyrtimit të dokumenteve nga zyra, në periudhën mes tetorit 2013 dhe tetorit 2014, OSBE-ja ka monitoruar 93 seanca dëgjimore në 50 raste të hapura që kishin të bënin me riuzurpimet e paligjshme të pronës, duke vëzhguar praktikën e procesit gjyqësor dhe prokurorial që ka të bëjë me riuzurpimet e paligjshme.

Kufizimi i mbulimit të hulumtimit vetëm në pronat e administruara nga AKP ka mundësuar një identifikim të lehtë të pronave që ishin subjekt i riuzurpimit. Një pengesë e këtij vendimi ishte se me këtë janë lënë jashtë rastet e riuzurpimeve të paligjshme të pronave në zotërim vetanak dhe ato nën administrim të pronarëve privatë. Megjithatë, procedurat për trajtimin e rasteve të riuzurpimit të paligjshëm nga prokuroria dhe gjykatat dhe faktet themelore të riuzurpimit të paligjshëm janë të njëjta pavarësisht nëse AKP-ja administron me pronën ose nëse prona është në administrim privat. Kështu, shqyrtimi i rasteve që përfshijnë rastet e administruara nga AKP mund të zbardhë mënyrën se si me gjasë trajtohen nga sistemi edhe rastet që përfshijnë prona që nuk administrohen nga AKP.<sup>6</sup>

Raporti është i ndarë në pesë pjesë. Pjesa e dytë paraqet një pasqyrë të kornizës ndërkombëtare dhe asaj të Kosovës. Pjesa e tretë përvijon çështjet e identifikuara në rastet në trajtimin efektiv të rasteve të riuzurpimit. Pjesa e katërt paraqet konkluzionet e raportet dhe, në fund, Pjesa jep rekomandime për akterët përkatës.

---

<sup>5</sup> Në rastet e mbetura, as nëpunësit e gjykatës as gjyqtarët nuk ishin në gjendje t'i gjejnë shkresat e lëndës. Megjithatë, në ato raste, fakti që rasti është përfunduar dhe data e aktgjykimit apo hedhjes së rastit është shënuar në regjistër.

<sup>6</sup> Shih shënimin më lartë 1.

## 2. KORNIZA LIGJORE NDËRKOMBËTARE DHE E KOSOVËS

### 2.1 Korniza ligjore ndërkombëtare

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) dhe protokollet e saj, si edhe Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut<sup>7</sup>, janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Kosovë<sup>8</sup>. Me rëndësi të veçantë është neni 1 i Protokollit të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Protokolli 1) i cili parashikon se çdo njeri ka të drejtë në gëzim paqësor të pronës dhe se askush nuk duhet të privohet në mënyrë të paligjshme nga pronës e tij.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka përcaktuar se çdo ndërhyrje në pronë duhet të jetë: 1) e ligjshme; 2) në interes publik, me fjalë të tjera, në zbatim të një qëllimi legjitim; dhe 3) proporcionale<sup>9</sup>. Sipas GJEDNJ, shkelja e nenit 1 të Protokollit 1 ndodh kur një aplikanti i është “mohuar qasja, kontrolli, përdorimi dhe gëzimi i pronës, si dhe kompensimi për ndërhyrje në të drejtat e tij pronësore”<sup>10</sup>. Asnjë nga rastet e vlerësuara për qëllime të këtij raporti nuk kanë përmbushur kërkesat e GJEDNJ-së për ndërhyrje të lejueshme në të drejtën e gëzimit të qetë të pronës.

### 2.2 Korniza ligjore e Kosovës

Riuzurpimi i pronës së paluajshme përbën vepër penale të sanksionuar me nenin 332 të Kodit Penal të Kosovës<sup>11</sup>. Neni 332, paragrafi 3, thekson se “Kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet nëse është dënuar më parë për uzurpim të kundërligjshëm të pronës së paluajshme ose nëse është dëbuar prej pronës së tillë të paluajshme me vendim të gjykatës apo me urdhër apo vendim të ndonjë organi apo institucioni tjetër të themeluar në bazë të ligjit të zbatueshëm[...]. “Ky paragraf është i aplikueshëm për rastet e riuzurpimit të një prone.

Dy vepra të tjera penale të cilat janë përdorur shpeshherë në lidhje me rastet e riuzurpimit të pronës janë, “Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave”<sup>12</sup>, dënohet me gjobë ose burgim deri në tre vjet, dhe “Cënimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve”<sup>13</sup>, që dënohet me burgim deri në tri vite. Vepra e parë penale përdoret shpeshherë për shkak se, pasi që të lirohet prona e uzurpuar nga AKP-ja, asaj gjithmonë i vendoset vula për të parandaluar uzurpuesit nga hyrja në të dhe largimi i vulës përbën vepër penale në vete; vepra e dytë penale është vepër e përgjithshme që parandalon kryerësit që të hyjnë në pronën private të dikujt. Asnjëra nga këto dy vepra të lartcekura penale nuk kërkon përcaktimin e “qëllimit” të kryerësit për të uzurpuar pronën për një periudhë më të gjatë kohore.

<sup>7</sup> Shih nenin 17(2) të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 10 dhjetor 1948, që thekson se “askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga prona e tij”. Shih gjithashtu nenin 1 të Protokollit të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ).

<sup>8</sup> Shih neni 22 të Kushtetutës së Kosovës, 15 qershor 2008.

<sup>9</sup> *Albergas dhe Arlauskas kundër Lituanisë*, paragrafi 58, GJEDNJ, Aktgjykimi i 27 majit 2014.

<sup>10</sup> *Orphanides kundër Turqisë*, paragrafi 35, GJEDNJ, Aktgjykimi i 20 janarit 2009, i plotfyqësishëm më 6 korrik 2009.

<sup>11</sup> Kodi Penal i Kosovës nr. 04/L-082 1 janar 2013.

<sup>12</sup> Po aty, neni 414.

<sup>13</sup> Po aty, neni 200.




### 3. SHQETËSIMET E IDENTIFIKUARA NË TRAJTIMIN EFEKTIV TË RASTEVE TË RIUZURPIMIT TË PALIGJSHËM

#### 3.1 Informata të përgjithshme


Mes viteve 2008 dhe 2013, Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) referoi në prokurori gjithsej 326 raste të riuzurpimit të paligjshëm nën administrimin e saj. OSBE-ja e pranoi këtë listë të rasteve nga AKP-ja dhe i përcjelli rastet përgjatë fazave të ndryshme të procedurës penale pranë zyrave të prokurorisë dhe gjykatave. Më shumë se 95 për qind e tyre përfshinin prona në pronësi të pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës që ishin riuzurpuar paligjshëm nga pjesëtarët e komunitetit shqiptar të Kosovës.

Në të gjitha rastet, AKP-ja, në përputhje me mandatin e saj, zbatoi dëbimin fillestar me ndihmën e PK. Dëbimet ishin të pasuksesshme në kuptim të asaj se më pas pronat u uzurpuan sërish. AKP-ja, në cilësinë e saj si administrator i pronës në fjalë, më pas u drejtua sistemit të drejtësisë penale për të trajtuar riuzurpimin.

Deri në tetor të vitit 2014, aktgjykimet e plotfuqishme u nxorën në 42 për qind (137 raste) të këtyre rasteve. Mesatarisht, dy vjet e tre muaj kohë u nevojitën për rastet për të cilat u nxor një aktgjykim i formës së prerë, nga dorëzimi i rastit nga PK në zyrën e prokurorit ndonëse (siç paraqitet më hollësisht në grafikun 1 më poshtë) kjo ndryshon shumë nga njëri rajon në tjetrin:



Siç mund të shihet në grafikun më poshtë, në dhjetor të vitit 2013 dukej se ishte shënuar përparim në përshtetimin e zgjidhjes së këtyre rasteve me një numër jashtëzakonisht të madh të aktgjykimeve të nxjerra për rastet e riuzurpimit të paligjshëm. Megjithatë ky përparim dëshmoi të jetë vetëm i përkohshëm.



OSBE-ja ka gjetur mangësi të mëdha në përpunimin dhe zbatimin e rasteve të riuzurpimit të paligjshëm që rrezikojnë të drejtën e gëzimit paqësor të pronës sipas nenit 1 të Protokollit 1. Gjetjet e veçanta janë paraqitur në hollësi në vijim.

### 3.2 Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP)

#### 3.2.1 Dorëzimi i kallëzimeve penale në Policinë e Kosovës

Mandati i AKP-së është zgjidhja e kërkesave pronësore për prona të paluajtshme private dhe kërkesat për të drejtën e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme private atëherë kur pronari nuk është në gjendje t'i ushtrojë këto të drejta,<sup>14</sup> dhe gjatë kryerjes së detyrave të veta ajo mund t'i vendos pronat nën administrimin e saj.<sup>15</sup> Monitorimi i OSBE-së tregon se në rastet e riuzurpimit të paligjshëm, AKP-ja dorëzon drejtpërdrejtë kallëzim penal për riuzurpim të paligjshëm vetëm në zyrat përkatëse të prokurorisë dhe jo edhe në PK.<sup>16</sup> Në asnjë rast AKP-ja nuk ka dorëzuar kallëzim penal në PK apo nuk ka kërkuar zbatimin e serishëm të njoftimit fillestar për dëbim. Kjo ndryshon nga procesi që përdoret për të zbatuar urdhrin fillestar për dëbim, gjatë së cilit proces AKP-ja punon ngushtë me PK për të siguruar se dëbimi po kryhet.

<sup>14</sup> Shih nenin 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/10.

<sup>15</sup> Shih nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 që përkufizon përgjegjësitë e AKP-së. Shih po ashtu nenin 16.5 të së njëjtës rregullore që përcakton se “çdo person i cili pa arsye ligjore hyn në pronën e plumbosur duke e thyer atë i nënshtrohet largimit nga prona nga organet për zbatimin e rendit dhe ligjit” (më pas e zëvendësuar me anë të Ligjit nr. 03/L-079 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, 13 qershor 2008). Shih po ashtu nenin 69 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës nr. 04/L-12 (KPPK), 1 janar 2013, që autorizon policinë për të hetuar veprat penale.

<sup>16</sup> Kjo është vërtetuar gjatë disa intervistave që monitoruesit e OSBE-së i kanë zhvilluar me përfaqësuesit e AKP në periudhën mes shtatorit të vitit 2013 dhe shkurtit të vitit 2014.

Mënyra më efektive përmes së cilës një i dyshuar mund të largohet menjëherë nga prona është nëse AKP paraqet kallëzim për dëbim të serishëm në PK, e cila më pas mund të vazhdojë me ekzekutimin e urdhrin fillestar për dëbim, ta largojë dhe/ose përkohësisht ta arrestojë dhe paraburgosë kryerësin.<sup>17</sup> Për shkak se kjo nuk bëhet, personi i cili uzurpon paligjshëm pronën mund të qëndrojë në pronë duke vazhduar të kryejë veprën penale të riuzurpimit të paligjshëm deri në zgjidhjen e rastit e që mund të zgjasë disa vite në disa gjykata.

Dorëzimi i kallëzimit pranë PK nuk parandalon AKP që ta referojë rastin edhe në prokurori. Duke qenë se riuzurpimi i paligjshëm është vepër penale, procedurat duhet gjithashtu të nisen me qëllim të ndjekjes penale të riuzurpuesit të paligjshëm dhe kompensimit të palës së dëmtuar.<sup>18</sup> Njoftimi i të dyja institucioneve për riuzurpim të paligjshëm mbase do të siguronte një trajtim fillestar më efektiv të rastit.


### 3.2.2 Përcjellja e rastit

Mënyra se si ruhen të dhënat/regjistrat për riuzurpimin e paligjshëm nga AKP-ja dhe se si përcillen nga institucionet e zbatimit të ligjit gjithashtu paraqet shqetësim. Lista që AKP ka ndarë me OSBE përmban 366 raste të referuara. Sidoqoftë, pas një hetimi shtesë nga OSBE-ja, del se 40 regjistra në listën e AKP-së ishin llogaritur dy herë. Prandaj, disa raste që në të vërtetë ishin zgjidhur, konsideroheshin si të pazgjidhura nga AKP-ja. Përveç kësaj, rreth 29 raste në listën e AKP-së të rasteve të referuara në prokurori nuk mund të gjendeshin as në prokurori, as në gjykata. Grafiku 3 më poshtë paraqet numrin e rasteve të referuara nga AKP-ja sipas rajonit.

---

<sup>17</sup> Neni 8.2 i Ligjit për policinë i jep PK autorizime të përgjithshme për të ndihmuar autoritetet qendrore dhe lokale të qeverisjes në kryerjen e detyrave të tyre publike, të tilla si dëbimi: “Me kërkesë të institucioneve të qeverisjes qendrore ose lokale, policia është e autorizuar t’ju ofroj ndihmë në kryerjen e detyrave publike, kur ka arsye për të besuar se siguria e personit ose e personave që kryejnë detyra publike mund të rrezikohet për shkak të rezistimit të mundshëm ndaj veprimeve të tyre.” Përveç kësaj, PK ka autorizim të përgjithshëm për të hyrë në ndërtesa për të ndaluar kryerjen e një veprë penale, të tillë si riuzurpimi i paligjshëm. Shih nenin 11.1 të Ligjit për policinë (“gjatë kryerjes së detyrave policore, zyrtari policor ka autorizim të ushtrijë kontroll të arsyeshëm mbi njerëzit dhe pronën në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve të tij apo të saj, të jap dhe të zbatoj urdhra dhe instruksione të ligjshme për anëtarët e shoqërisë në përgjithësi, për t’i arritur objektivat ligjor të policisë”). Policia edhe mund ta arrestojë përkohësisht dhe ta ndalojë një person, si një riuzurpues të paligjshëm, i cili kapet në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale. Shih nenin 162 të KPK, (“Kur një person kapet në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare ose është në ndjekje për veprën e kryer penale, policia ose çdo person tjetër është i autorizuar ta arrestojë atë përkohësisht edhe pa urdhër të gjykatës”). Shih fusnotën 15 më sipër.

<sup>18</sup> Shih nenin 6(2) të KPK që përcakton: “procedura penale fillohet vetëm me vendim të prokurorit të shtetit kur ekziston dyshim i bazuar se është kryer vepër penale.” Shih po ashtu nenin 6(3) që përcakton se “prokurori i shtetit mund të fillojë procedurën penale në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni pas marrjes së informacionit nga policia, institucioni tjetër publik, institucioni privat, qytetari, media, nga informacioni i marrë në një procedurë tjetër penale ose pas ankimit ose propozimit të dëmtuarit.” Shih fusnotën 15 më sipër.




Ngatërrimet rreth numrit të vërtetë të rasteve të riuzurpimit në lidhje me pronën e administruar nga AKP-ja dhe statusi i këtyre rasteve pengon zbatimin efektiv të këtyre veprimeve. Mbajtja më e mirë e të dhënave dhe një komunikim më proaktiv mes AKP-së dhe zyrave të prokurorisë për statusin e rasteve është i nevojshëm për të qartësuar rëndësinë e çështjes së riuzurpimit të paligjshëm.

### 3.3 Çështjet lidhur me zyrat e prokurorisë

#### 3.3.1 Rastet ende të pazgjidhura pranë zyrave të prokurorisë

Deri në tetor të vitit 2014, 71 raste janë referuar nga AKP në zyrat e prokurorisë në periudhën viteve 2008 dhe 2013 të cilat ende nuk ishin trajtuar në zyrat e prokurorisë, pra as me ngritjen e aktakuzës, as me akuza të hedhura poshtë nga prokurorët. Grafiku 4 më poshtë paraqet hollësitë e trajtimit të rasteve të pranuar nga AKP-ja sipas rajonit.




Trajtimi i rasteve nga zyrat e prokurorisë në Prishtinë/Priština dhe Mitrovicë/Mitrovica ngre shqetësime të veçanta. Nga 36 raste të paraqitura nga AKP-ja në zyrën e prokurorisë në Prishtinë/Priština, 17 raste janë ende të pa trajtuara. Sipas prokurorëve në këtë zyre, në të gjitha 17 rastet identiteti i kryerësit nuk mund të përcaktohej. Duke marrë parasysh atë se AKP-ja tashmë kishte nxjerrë urdhër për dëbim ndaj uzurpuesve, është e paqartë përse prokurorët nuk mund të përcaktojnë identitetin e kryerësve. Numri i madh i rasteve ku uzurpatori emërtohet si i “panjohur” tregon për dështim në procesin e hetimit.

Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica gjendja është më e ndërlikuar sesa në rajonet e tjera. AKP-ja konfirmoi se i ka dorëzuar 65 raste në zyrën e prokurorisë mes viteve 2008 dhe 2013.<sup>19</sup> Zyra e prokurorisë deklaroi se ka pranuar 53 raste, por aktakuza është ngritur vetëm në dy prej tyre.<sup>20</sup> Për më tepër, për shkak të mungesës së hapësirave për zyre dhe kushteve të vështira të punës, zyra e prokurorisë në Mitrovicë/Mitrovica i ka kërkuar AKP-së që të mos paraqes më raste të tjera deri në njoftim tjetër. Duke pasur parasysh se natyra e këtyre rasteve është kryesisht ndëretnike dhe e lidhur me konfliktin, si dhe që karakteri i tyre është relativisht i thjeshtë, këto raste duket se janë të atij lloji që duhet të trajtohen nga zyra e prokurorisë në Mitrovicë/Mitrovica pa marrë parasysh kushtet e punës në të cilat punohet.

### 3.3.2 Koha e nevojshme për të ngritur aktakuzën

Në mbarë Kosovën, koha mesatare që nevojitet për ngritjen e aktakuzës që nga momenti kur dorëzohet kallëzimi penal pranë cilësdo zyre të prokurorisë është pesë muaj, ndonëse (siç paraqet më hollësisht grafiku 5 më poshtë) kjo ndryshon nga një rajon në tjetrin.



Rastet e riuzurpimit të paligjshëm të pronave nuk janë të ndërlikuara nga perspektiva juridike, meqë: ato zakonisht përfshijnë vetëm një të pandehur; shkalla e provave është mesatare; niveli i ndërlikimit të çështjeve juridike është i ulët si dhe nuk ka

<sup>19</sup> AKP-ja siguroi listën e rasteve të pazgjidhura pranë gjykatave në Kosovë, shkurt 2014.

<sup>20</sup> Në kohën e botimit, ishin të panjohura arsyet përse vetëm këto dy aktakuza ishin ngritur.

konteste të pazgjdhura pronësore. Për këto arsye, zyrat e prokurorisë duhet të ngrënë aktakuza më shpejtë se që kanë bërë gjatë periudhës së mbuluar në këtë raport. Zyrat e prokurorisë në Gjilan/Gnjilane, Pejë/Peć, dhe Gjakovë/Đakovica, në një afat prej dy muajsh ose më pak, treguan se kjo gjë është e mundshme. Në të vërtetë, siç mund të shihet në grafikun 3, dy nga këto zyra – ajo në Pejë/Peć dhe Gjakovë/Đakovica – kanë numër më të madh të këtyre rasteve në krahasim me disa rajone që reagojnë më ngadalshëm, të tilla si Prizreni dhe Prishtina/Priština.

### 3.3.3 Përmbajtja e aktakuzës

Mes vitit 2008 dhe fundit të vitit 2012, zyrat e prokurorisë ngritën propozimakuza në 220 raste, siç kishin të drejtë sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale.<sup>21</sup> Që nga 1 janari 2013, aktakuzat e rregullta u ngritën duke qenë se më nuk ishte e mundshme parashtrimi i propozimakuzës sipas Kodit të ri të Procedurës Penale. Megjithatë aktakuzat e rregullta të ngritura në vitin 2013 ishin kryesisht të formës së propozimakuzës. Për shembull, prokurorët dështuan që të përshkruajnë siç duhet natyrën ndëretnike të rastit dhe në përgjithësi ata e konsideronin AKP e jo pronarin e vërtetë të pronës, si palë të dëmtuar duke qenë se prona është nën administrimin e AKP-së. Pronari i vërtetë i pronës në përgjithësi nuk është cekur në propozimakuzë/aktakuzë dhe gjithashtu nuk është konsideruar si dikush i cili do të duhej ftuar në shqyrtim gjyqësor.<sup>22</sup>

### 3.3.4 Akuzat e ngritura

Në 117 rastet e përfunduara që OSBE i ka shqyrtuar në hollësi, prokurorët kanë dështuar të ngritin akuza të duhura duke i pasur parasysh faktet. Për shembull, në 94 raste është ngritur aktakuzë vetëm për kryerjen e veprës “heqje apo dëmtim i vulave apo shenjave zyrtare”<sup>23</sup>, ndonëse nga faktet e çështjes duket qartë se i pandehuri ka hequr vulën zyrtare në mënyrë që të mund të hyjë sërish në pronë. Meqë të pandehurit nuk akuzohen edhe për “uzurpim në mënyrë të paligjshme të pronës së paluajtshme,”<sup>24</sup> përveçse për heqje të vulës zyrtare, aktgjykimi nuk përmban udhërin për dëbimin e të pandehurit nga prona.<sup>25</sup> Për më tepër, duke e akuzuar të pandehurin vetëm për një vepër penale në vend se për dy, nuk arrihet që të dëshmohet pesha e rastit dhe të shqiptohet një dënim më i lartë për dy veprat në bashkim.<sup>26</sup>

Përrjashtim përbëjnë lëndët e paraqitura në Gjykatën Themelore të Gjakovës/Đakovica: nga 32 aktgjykime të prera që janë shqyrtuar, në të gjitha rastet me përjashtim të njërit të pandehurit janë akuzuar për kryerjen e të dyja veprave penale.

<sup>21</sup> Shih Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, të shpallur me anë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/25, 6 korrik 2003, me ndryshimet përcjellëse. Më 6 nëntor 2008, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin nr. 03/L-002 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e më tutjeshëm: KPPK), kapitulli XL: procedura e shkurtër, nenet 461 dhe 462 propozimakuza zbatohet në procedurën e shkurtër për të cilat si dënim kryesor është paraparë gjoja apo burgimi deri në tre vjet.

<sup>22</sup> Shih nenin 62 të KPK, fusnota 15 më sipër.

<sup>23</sup> Neni 322, KPK. Gjithashtu, neni 414, KPP, shënimi i 15-të i mësipërm.

<sup>24</sup> Neni 259, KPK. Gjithashtu neni 332, KPP, shënimi i 15-të i mësipërm.

<sup>25</sup> Vepra e parë “konsumohet” me heqjen e vulës zyrtare, ndërkaq vepra e dyte penale kryhet në vazhdimësi, për aq kohë sa prona e paluajtshme të jetë në posedim të të pandehurit.

<sup>26</sup> Sipas KPK, dënimin maksimal për kryerje të veprës penale të heqjes së vulave zyrtare ishte më i lartë se sa ai për veprën penale të uzurpimit të paligjshëm. Tani KPP nuk e parasheh një gjë të tillë.

### 3.3.5 Ndëshkimet e kërkuara


Gjatë shqiptimit të dënimeve, OSBE ka vërejtur që prokurorët gjithnjë mbanin qëndrim pasiv, duke i lënë gjithçka në dorë gjyqtarit dhe duke mos dhënë asnjë sugjerim për dënimin, por thjesht propozonin vetëm që të pandehurit të dënoheshin “në pajtim me ligjin”. Madje edhe atëherë kur prokurorët kërkonin të shqiptohet ndonjë dënim specifik, në të shumtën e rasteve fjala ishte për dënime që ishin ose dënime minimale ose aty diku afër tyre. Për shembull, në disa raste prokurorët kanë kërkuar vetëm urdhër ndëshkimor (me fjalë të tjera, gjobë).

Parë së bashku, faktorët e sipërpërmendur duket sikur sugjerojnë që në shumë raste nuk janë zhvilluar hetime dhe ndjekje penale efektive. Në lidhje me këtë, GJEDNJ ka konstatuar që “nëse pengimi është i natyrës penale, institucionet janë gjithashtu të obliguara që të kryejnë hetim penal dhe, po të jetë nevoja, ndjekje penale efektive”.<sup>27</sup>

## 3.4 Çështjet që kanë të bëjnë me gjykatat

### 3.4.1 Vonesat e paarsyeshme

Nga 220 akuza dhe propozimakuza të ngritura nga prokuroritë, gjykatat themelore kanë nxjerrë vendim për 137 raste. Gjykata të caktuara përballen me numër të madh të lëndëve të pazgjidhura. Grafiku 6 i mëposhtëm, pasqyron në hollësi statusin e rasteve të paraqitura nëpër gjykata themelore deri në tetor të vitit 2014.<sup>28</sup>




Vonesa të mëdha paraqiten edhe gjatë procedimit të këtyre lëndëve nëpër gjykata. Për të nxjerrë një aktgjykim duhen mesatarisht 22 muaj, megjithëse kohëzgjatja dallon shumë nga njëra gjykatë në tjetrën. Grafiku 7 i mëposhtëm pasqyron në hollësi kohëzgjatjen mesatare deri në zgjidhjen e lëndëve për secilën gjykatë

<sup>27</sup> *Blumberga kundër Letonisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ i 14 tetorit 2008.

<sup>28</sup> Shih shënimin e 5-të të mësipërm. Në disa raste, gjykata themelore nuk ka qenë në gjendje që ta paraqesë dosjen e lëndës, por vetëm fakte që ka përfunduar lëndën dhe që data e nxjerrjes së aktgjykimit apo lirimit nga akuza është regjistruar në shkrimoren e gjykatës.

themelore, krahasuar me numrin e lëndëve të pazgjidhura me të cilat përballen këto gjykata: numri i lëndëve të pazgjidhura për gjyqtar.<sup>29</sup> Siç mund të shihet nga Grafiku 7, nuk ka ndonjë ndërlidhje ndërmjet efikasitetit në zgjidhjen e rasteve të riuzurpimeve në mënyrë të paligjshme dhe ngarkesës së përgjithshme me lëndë të pazgjidhura. Disa gjykata që kanë numër relativisht të madh të lëndëve të pazgjidhura (p.sh. Prishtinë/Priština) i zgjidhin lëndët shpejt, derisa të tjerat që kanë numër të vogël të lëndëve të pazgjidhura (p.sh. Gjilan/Gnjilane) i zgjidhin ngadalë.



Karakteristikat e veçanta të lëndëve të riuzurpimit në mënyrë të paligjshme – natyra e tyre relativisht e thjeshtë, elementi ndëretnik, si dhe ndikimi në të drejtat e komunitetit serb të Kosovës në pronë dhe banim – tregojnë që këto lëndë do të duhej të shqyrtoheshin në mënyrë më të përshtetshme.<sup>30</sup> Megjithatë, në disa gjykata këto lëndë nuk po trajtohen me urgjencën e duhur. Fakti që Gjykata Themelore e Prishtinës/Priština dhe ajo e Gjakovës/Đakovica mund t'i zgjidhin lëndët për mesatarisht afro 10 muaj dëshmon që këto lëndë mund të procedohen relativisht shpejt, pavarësisht ngarkesës relativisht të madhe me lëndë të pazgjidhura, siç është rasti në Gjykatën Themelore të Prishtinës/Priština.

### 3.4.2 Shqiptimi i dënimit


Dënimet e ulëta përbëjnë shqetësim të madh. Nga 117 lëndët e përfunduara me aktgjykim të cilat i ka shqyrtuar në hollësi OSBE, vetëm 97 kanë rezultuar me

<sup>29</sup> “Numri i lëndëve të pazgjidhura për gjyqtar në fund të vitit 2013” llogaritet duke e pjesëtuar numrin e lëndëve në punë që ende nuk janë zgjidhur në gjykatën themelore të caktuar në fund të vitit 2013 me numrin e gjyqtarëve të caktuar në atë gjykatë. Të dhënat e nevojshme për këtë llogaritje janë siguruar nga *Raporti vjetor i KGJK 2013: Statistika e gjykatave*, në dispozicion në [http://kgjk-ks.org/repository/docs/RAPORTI-VJETOR-2013-Anglisht\\_885030.pdf](http://kgjk-ks.org/repository/docs/RAPORTI-VJETOR-2013-Anglisht_885030.pdf)

<sup>30</sup> Shih KPP në përgjithësi, shënimi i 15-të i mësipërm, dhe për shembull: nenin 159, për afatet kohore të hetimit dhe ngritjes së aktakuzës. Shih gjithashtu nenet 242, 245, 285, dhe 314 që përcaktojnë hollësisht afatet kohore për shqyrtimin fillestar, shqyrtimin e dytë dhe për shqyrtimin gjyqësor.



aktgjykim dënues. Grafiku 8 i mëposhtëm pasqyron në hollësi dënimet që janë shqiptuar për këto 97 raste.



As edhe për një rast të vetëm nuk janë shqiptuar dënime privuese të lirisë. Përkundrazi, nga 34 gjoba të shqiptuara, më larta e vrojtuar nga OSBE-ja ka qenë një gjobë në shumën prej €600. Janë identifikuar gjithsej 59 dënime me kusht, ndër të cilët më i ashpri ishte dënim me kusht me një vit burgim nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale brenda dy viteve të ardhshme. Një faktor që ka kontribuar në nxjerrjen e vendimeve të këtilla të ulëta është pasiviteti i prokurorëve gjatë shqyrtimit gjyqësor. Megjithatë, gjykatat e kanë në fund të fundit për detyrë që të garantojnë proces të rregullt gjyqësor dhe të sigurojnë që të merren parasysh faktorët, përfshirë këtu gjithë rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ashtu që dënimi që shqiptohet të reflektojë në masë të mjaftueshme peshën e krimit. Gjithashtu, përveç shpalljes fajtor të të pandehurit për uzurpim të paligjshëm të pronës, gjyqtarët duhet që në dispozitivët e aktgjyqimeve dënues të saktësojnë gjithmonë që i pandehuri duhet të largohet nga prona, nëse ndodh që ky i fundit vazhdon ta uzurpojë atë. Sidodoqftë, në rastet në fjalë, dëbimi i të pandehurit nga prona është urdhëruar në vetëm shtatë nga rastet në fjalë, të gjitha lëndë të Gjykatës Themelore në Gjakovë/Đakovica, gjë që tregon se uzurpimi i pronave mund të vazhdojë edhe pas përfundimit të procedurës penale.<sup>31</sup>

<sup>31</sup> Gjykata Themelore në Gjakovë/Đakovica, Aktgjykimi P. Nr. 95/2012 i 21 gushtit 2013, Aktgjykimi P. Nr. 241/12 i 28 qershorit 2012, Aktgjykimi P. Nr. 236/12 i 14 nëntorit 2012, Aktgjykimi P. Nr. i 19 nëntorit 2012, Aktgjykimi P. Nr. 231/12 i 28 qershorit 2012, Aktgjykimi P. Nr. 19/12 i 17 majit 2012, Aktgjykimi P. Nr. 311/12 i 7 gushtit 2012.

### 3.4.3 *Kompensimi*

Gjykatat nuk nxjerrin gjithashtu as vendim për kompensimin e pronarit, ndonëse një e drejtë e tillë parashihet me Kodin e Procedurës Penale.<sup>32</sup> Gjykatat nuk kanë caktuar kompensim në asnjërin prej 97 aktgjykimeve fajësuese që i ka shqyrtuar OSBE. Në vend të kësaj, pas shpalljes së dënimit, gjykatat zakonisht e udhëzojnë AKP-në<sup>33</sup> (apo pronarin e pronës, nëse është i pranishëm) që të ngritë padi civile për kompensim të dëmit, e që është praktikë shumë joefikase dhe mbas gjase në dëm të palës së dëmtuar, e cila do të duhet që të bëjë shpenzime shtesë dhe të presë më shumë kohë derisa ta realizojë kërkesën në gjykata civile. Gjykata penale do të duhej që ta udhëzojë palën e dëmtuar mbi të drejtën për të kërkuar dhe realizuar kërkesat pronësore. Gjykata mund ta referojë palën për të iniciuar procedurë të veçantë civile vetëm nëse vlerëson se nuk ka prova të mjaftueshme për ta mbështetur kërkesën pronësore.<sup>34</sup> Siç u përmend më parë, në këtë kuptim GJEDNJ ka konstatuar që institucionet kanë detyrimin pozitiv për të siguruar që “të drejtat në pronë të mbrohen në masë të mjaftueshme me ligj, dhe të sigurohen mjete juridike të përshtatshme që do t’i mundësonin viktimës të kërkojë realizimin e tyre, duke përfshirë, po të jetë e përshtatshme, kërkimin e kompensimit për çfarëdolloj humbjesh të shkaktuara”.<sup>35</sup> Mospërfshirja e kërkesës për kompensim shkon kundër frymës së këtyre standardeve ndërkombëtare, sidomos po të merret parasysh që të dëmtuarit në këto raste ka të ngjarë të jenë PZHBV dhe, për rrjedhojë, kanë më pak mundësi të kërkojnë drejtësi në gjykatat e Kosovës.

### 3.4.4 *Ekzekutimi i dënimeve*

Në fund, mangësi ka edhe për sa i përket zbatimit të dënimeve. Vetëm 20 nga 34 gjodat e shqiptuara janë paguar, ndonëse shkalla e ekzekutimit të vendimeve dallon në masë të madhe nga njëra gjykatë themelore në tjetrën. Grafiku 9 i mëposhtëm pasqyron në hollësi statusin e ekzekutimit të gjobave në ato gjykata themelore që kanë shqiptuar gjoba deri në tetor 2014.

---


<sup>32</sup> Neni 62 i KPP, shënimi i 15-të i mësipërm.

<sup>33</sup> AKP siguron përfaqësim ligjor për të gjitha rastet nënë administrimin e saj.

<sup>34</sup> Neni 463, KPP, shënimi i 15-të i mësipërm.

<sup>35</sup> Blumberga kundër Letonisë, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 14 tetorit 2008, paragrafi 67.

**Grafiku 9: Gjjobat e paguara sipas gjykatave themelore (deri në tetor të vitit 2014)**



Vetëm në një rast në Gjykatën Themelore të Gjilanit/Gnjilane është shqiptuar dënim privues nga liria për mospagesë të gjobës.<sup>36</sup> Për më tepër, duket se mungon një (qoftë në gjykata, qoftë në prokurori), që do ta bënte të mundur të verifikohet nëse kryesi të cilit i shqiptohet dënimi me kusht ka kryer ndonjë vepër tjetër gjatë periudhës sa ka zgjatur dënimi.

#### 4. PËRFUNDIM

Vlerësimi i mësipërm shpërfaq mangësi serioze në zbatimin, ndjekjen dhe gjykimin e këtyre veprave, duke vënë kështu në rrezik realizimin e së drejtës për të gëzuar në mënyrë paqësore pronën të paraparë me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ. Duke marrë parasysh natyrën e veprës dhe potencialin që ka ajo për të dëmtuar raportet ndëretnike, këtyre rasteve duhet t’ju kushtohet rëndësi nga të gjitha institucionet gjegjëse dhe duhet të merren masa për të siguruar që riuzurpuesit e paligjshëm të largohen nga pronat dhe të marrin dënimet e duhura brenda një kohe të arsyeshme.

Për shembull, për të siguruar zbatim të urdhrit për dënim të nxjerrë herën e parë, AKP duhet të paraqesë kallëzim penal në polici në rast të riruzurpimit të pronës që ka nën administrim. Megjithatë, vlerësimi ka vënë në dukje që AKP nuk përdorë ndihmën e policisë për të siguruar zbatimin e urdhrit për dënim. Prokuroritë po dështojnë vazhdimisht që ta vënë në dukje natyrën ndëretnike të këtyre rasteve dhe të kërkojnë dënime që do t’i parandalonin veprimet e tilla në të ardhmen. Gjithashtu, pavarësisht nga elementi ndëretnik dhe natyra e qartë e rasteve të riuzurpimit në mënyrë të paligjshme, disa prokurori dhe gjykata nuk i shqyrtojnë ato me urgjencën e duhur.

<sup>36</sup> Gjjoba e shqiptuar prej €200 u zëvendësua me 13 ditë burgim për shkak të mospagesës.

Si rrjedhojë e këtij mosefikasiteti, riuzurpuesit po munden që të vazhdojnë të qëndrojnë në prona deri në zbatimin e plotë të vendimit për dëbim, e që mesatarisht merr afro dy vjet e tre muaj, dhe dënimet për këto veprime janë jashtëzakonisht të buta. Nga 326 raste të riuzurpimit të raportuara nga AKP prej 2008 deri në 2013, janë paguar vetëm 20 gjoba dhe vetëm një person ka vuajtur dënim privues lirie për arsye të mospagesës së gjobës. Nuk është shqiptuar asnjë dënim privues lirie, dhe nuk është nxjerrë asnjë urdhër për kompensim të pronarëve.

Me gjithë këto mangësi thelbësore, ka megjithatë edhe ca praktika të mira. Për shembull, në Gjakovë/Dakovica, paravarësiht nga problemet sikurse mosnxjerrja e urdhrave për kthim të pronës dhe mosekzekutimi i dënimeve, rastet procedohen nga prokuroritë dhe zgjidhen nga Gjykata Themelore brenda një viti nga momenti kur AKP paraqet rastin në prokurori. Për më tepër, nga sa ka vërejtur OSBE, prokuroria në Gjakovë/Dakovica është e vetmja që i akuzon kryerësit si për veprën penale të “heqjes apo dëmtimit të vulave zyrtare ose shenjave” ashtu edhe atë të “uzurpimit të paligjshëm të pronës së paluajtshme”, ndërsa Gjykata Themelore e Gjakovës/Dakovica është e vetmja që në aktgjykim urdhëron edhe dëbimin (ndonëse kjo praktikë nuk ka qenë e rregullt).

## **5. REKOMANDIME**

### **Agjencia Kosovare e Pronës**

- Të ngritë me kohë kallëzime penale në Policinë e Kosovës dhe zyra të prokurorëve sa herë që vihet në dijeni të riuzurpimit të paligjshëm.
- T'i udhëzojë prokurorët që përveç gjatëzimit dhe/ose dënimeve me privim lirie të kërkojnë edhe kompensim financiar.
- Të sigurojë regjistrimin sistematik të të dhënave rreth riuzurpimeve dhe përcjelljen e vazhdueshme të ecurisë së rasteve të paraqitura në Policinë e Kosovës dhe prokuroritë.

### **Për prokurorët publikë**

- T'i procedojnë shpejtë për në gjykata rastet e riuzurpimit të pronës në mënyrë të paligjshme.
- Të përmirësojnë cilësinë e akuzave të ngritura ashtu që, për shembull, të përmendin natyrën ndëretnike të rastit dhe pronarit.
- Të ngritin akuza për shkelje të dispozitave që rregullojnë heqjen e vulave zyrtare, si edhe riuzurpimin e pronave.
- Të jenë proaktivë në kërkimin e dënimeve, ndëshkimeve dhe në raste të caktuara edhe dënimeve me privim lirie për të shërbyer si parandalim në të ardhmen.
- Të kërkojnë kompensim financiar për pronarin e pronës.
- Të sigurojnë mbajtjen e regjistrave për personat e dënuar me kusht.

### **Për gjykatat**

- Së paku, rastet e riuzurpimit t'i shqyrtojnë brenda afateve kohore të parapara me ligj.
- T'i kushtojnë vëmendje natyrës ndëretnike të rastit dhe nevojës për të shqiptuar dënime që do ta ndalonin përsëritjen e kësaj veprë në të ardhmen.
- Të nxjerrin urdhër për kompensim financiar të pronarit, përveç rasteve kur është e qartë se një gjë e tillë është e perealizueshme për shkak të natyrës komplekse të çështjes.
- Në dispozitivin e aktgjykimeve fajësuese, të përfshijnë gjithmonë një nen që përcakton largimin e gjithë uzurpuesve të paligjshëm nga prona.



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë  
**Misioni në Kosovë**

**SHQYRTIM I RASTEVE TË**  
*riuzurpimit të paligjshëm*  
**NË KOSOVË**

JANAR 2015